



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201802500/11

Tiranë ___/___/2019

Lënda: Marrjen e masave për zbatimin korrekt të rekomandimit nr.K5/I7-9, datë 26.3.2019, të Avokatit të Popullit.

MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

ZONJËS BESA SHAHINI

TIRANË

E nderuar zonja Shahini,

Më lejoni, që nëpërmjet këtij komunikimi, të ndaj me Ju shqetësimin, lidhur me qëndrimin zyrtar, aspak në frymën e Kushtetutës dhe të legjislacionit në fuqi, të Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë.

Me keqardhje vërejmë mungesë të hapur bashkëpunimi, në funksion të respektimit dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, karshi institucionit të Avokatit të Popullit, si një institucion kombëtar, i pavarur dhe kushtetues dhe, që themel të punës së tij ka mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të njeriut e, sidomos, fëmijëve nga veprimet dhe mos veprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, shtetërore.

Pikërisht, për përmbushjen e këtij misioni, Avokati i Popullit, përgjatë gjithë veprimtarisë së tij administrative, përfshirë edhe rastin konkret, është udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizimit dhe pavarësisë.

Konkretisht, në shkresën zyrtare me nr.K5/I7-9 prot., datë 26.3.2019, institucioni i Avokatit të Popullit i dërgoi Bashkisë Tiranë dhe Drejtorisë

Arsimore Rajonale Tiranë, rekomandimet përkatëse për të garantuar të drejtat e fëmijëve në kopshtin 22 Tiranë.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit është brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të shkresës zyrtare, afat kohor ky, i pazbatuar nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë.

Në këtë kuptim, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me nenin 23, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Avokati i Popullit nëse nuk merrë përgjigje nga institucionet e administratës publike, ka të drejtë ta ndjekë çështjen te organi më i lartë në hierarki.

Bashkëlidhur, gjeni një kopje të rekomandimit nr. K5/I7-9, datë 26.3.2019.

Për, sa më sipër, lutemi në vijim të na informoni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi. Ky rekomandim është pjesë e raportimit periodik të institucionit të Avokatit të Popullit pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë sipas vendimit nr.49/2017, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, si dhe do të vlerësohet edhe nga grupi i ngritur për këtë qëllim nga Kryetari i Kuvendit.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve.

AVOKAT I POPULLIT

Erinda BALLANCA